

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "ADMINISTRIM ZYRE "

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Kemi të bëjmë me tepricë oferte atëherë kur: **1 pikë**
- A) Sasia e kërkuar tejkalon sasinë e ofruar;
  - B) Sasia e ofruar është më e vogël sesa sasia e kërkuar;
  - C) Sasia e ofruar tejkalon sasinë e kërkuar;
  - D) Sasia e kërkuar është e barabartë me sasinë e ofruar;
2. Çmimi tavan vendoset nga qeveria: **1 pikë**
- A) Për të mbrojtur interesat e blerësve;
  - B) Për të mbrojtur interesat e shitësve;
  - C) Për të rritur të ardhurat e saj;
  - D) Për të mbrojtur interesat e blerësve dhe shitësve;
3. Kostot që nuk ndryshojnë kur ndryshon sasia e prodhuar, quhen kosto: **1 pikë**
- A) Fikse;
  - B) Oportune;
  - C) Të përgjithshme;
  - D) Të ndryshueshme;
4. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk përbën funksion të qeverisë në ekonomi: **1 pikë**
- A) Qeveria luan rolin e arbitrit;
  - B) Qeveria luan rolin e menaxherit;
  - C) Qeveria luan rolin e lojtarit në treg;
  - D) Qeveria luan rolin e punëdhënësit kryesor në shkallë ekonomie;
5. Me inflacion kuptojmë: **1 pikë**
- A) Ndryshimet në çmimet relative të mallrave;
  - B) Rënien e nivelit të përgjithshëm mesatar të çmimeve;
  - C) Rritjen e vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve;
  - D) Rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve të mallrave industriale;
6. Kur menaxheri merret me hartimin e kontratave apo marrëveshjeve të kompanisë duke mbrojtur interesat e saj kemi të bëjmë me rolin e tij vendimor si : **1 pikë**
- A) Sipërmarrës;
  - B) Negociator;
  - C) Shpërndarës të burimeve;
  - D) Trajtues i shqetësimeve të ndryshme;
7. Përcaktimi i gjendjes reale të organizatës në raport me qëllimet e vendosura, është detyrë e funksionit të: **1 pikë**
- A) Planifikimit;
  - B) Kontrollit;
  - C) Udhëheqjes;
  - D) Organizimit;

8. Metodatat e departamentizimit shoqërohen me një sërë avantazhesh dhe disavantazhesh. Duke u specializuar për klientë të veçantë rritet cilësia e shërbimit dhe efektiviteti i punës së departamenteve, kjo është avantazh i metodës sipas :

**1 pikë**

- A) Kohës ;
- B) Procesit;
- C) Klientit ;
- D) Produktit ;

9. Elementet që përbëjnë procesin e komunikimit janë disa. Tërësia e shenjave që do të përdoren për krijimin e mesazhit, kanë të bëjnë me elementin:

**1 pikë**

- A) Kodim ;
- B) Kontekst;
- C) Zhurmë;
- D) Mesazh;

10. Cila nga alternativat nuk qëndron kur flasim për karakteristikatat e komunikimit si disiplinë:

**1 pikë**

- A) Sistematik;
- B) I kuptueshëm;
- C) Dekonstruktiv;
- D) I qëndrueshëm ;

11. Kemi të bëjmë me komunikimin nga poshtë lart në rast se komunikojnë :

**1 pikë**

- A) Dy ose më shumë anëtarë të të njëjtit grup;
- B) Anëtarë të grupeve të ndryshme të të njëjtit nivel;
- C) Shërben për të dhënë informacion në lidhje me mënyrën se si po punohet;
- D) Shërben për të përcaktuar objektivat dhe për të dhënë instruksionet e punës;

12. Psikologët dhe studiuesit e komunikimit dallojnë katër lloje të dëgjimit. Nëse flasim për aftësinë e leximit të ndjenjave, emocioneve të folësit, fjala është për dëgjimin:

**1 pikë**

- A) Kritik;
- B) Pasiv;
- C) Aktiv;
- D) Empatik;

13. Cila nga alternativat e mëposhtme përjashtohet nga karakteristikatat që ngrenë strukturën e një grupi:

**1 pikë**

- A) Roli;
- B) Gjinia;
- C) Statusi;
- D) Lidhshipi;

14. Stilet e komunikimit janë katër. Nëse flasim për një stil komunikimi i cili bazohet në imponimin e nevojave dhe opinionëve mbi të tjerët pa marrë parasysh atë që të tjerët mendojnë apo ndjejnë i referohemi stilit të komunikimit : **1 pikë**
- A) Pasiv;
  - B) Agresiv;
  - C) Të sigurtë;
  - D) Pasiv- agresiv;
15. Intervista si një metodë kërkimi është një bashkëbisedim i: **1 pikë**
- A) Paplanifikuar;
  - B) Qëllimshëm;
  - C) Rastësishëm;
  - D) Improvizuar;
16. Burimi i informacionit ose referenca shërben : **1 pikë**
- A) Për të nxjerrë në pah aftësitë e shkruarit;
  - B) Për të treguar se shkruari ka liri gjatë hartimit të dokumentit shkresor;
  - C) Për të dhënë një burim vërtetësie në një material shkresor;
  - D) Për t'i imponuar lexuesit tituj veprash dhe emra autorësh të ndryshëm;
17. Cila nga alternativat e mëposhtme përjashtohet nga format e drejtpërdrejta të të shkruarit që përdor shkrimi informal: **1 pikë**
- A) Shkurtesa dhe fjali të gjata;
  - B) Fjali të shkurtra dhe të thjeshta;
  - C) Ton personal dhe subjektiv;
  - D) Gjuhë të strukturuar lirshëm;
18. Konfliktet intrapersonale janë konflikte që personi i ka me veten. Këto konflikte paraqiten në disa forma. Cila nga alternativat nuk paraqet formën e këtij lloji ? : **1 pikë**
- A) Lodhja;
  - B) Simpatia;
  - C) Frustracioni;
  - D) Agresioni;
19. Aftësitë që ka menaxheri për të motivuar, udhëhequr dhe komunikuar me njerëzit janë aftësitë: **1 pikë**
- A) Teknike
  - B) Ndërpersonale
  - C) Konceptuale
  - D) Profesionale

20. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e shprehur saktë kur flasim për elementët e rëndësishëm të strukturës organizative: **1 pikë**

- A) Marrëdhëniet midis njerëzve janë të përcaktuara joformalisht;
- B) Struktura organizative siguron një hierarki,( sistemi i nënshtrimit dhe superiores);
- C) Elementët e strukturës organizative janë të ndara në njësi organizative;
- D) Funksionimi i strukturës organizative siguron diferencimin dhe koordinimin e komponentëve;

21. Supozojmë se kërkesa për raketa tenisi jepet nga tabela e mëposhtme:

Çmimi	Sasia e Kërkuar D	Sasia e ofruar S
10	600	60
20	480	120
30	360	180
40	240	240
50	120	300
60	0	360

Kërkohet:

a) Për cilin çmim tregu është në ekuilibër, pra  $P_e=Q_e=$  **1 pikë**

b) Përcaktoni dy çmime, për të cilat tregu është në mungesë oferte **2 pikë**

c) Përcaktoni një çmim, për të cilin tregu është me tepriçë oferte **1 pikë**

22. Qeveria si arbitër realizon disa funksione. Listoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

23. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë.

4 pikë

a) Taksa të sheshta janë ato që të gjithë paguajnë në të njëjtën përqindje të të ardhurave, të pasurisë ose shpenzimeve të tyre.

PO JO

b) Taksat progresive janë ato që paguhen në përqindje më të vogla nga ata që kanë të ardhura më të larta.

PO JO

c) Taksat regresive janë ato që paguhen në përqindje më të vogla nga ata që kanë të ardhura më të larta.

PO JO

d) Taksat të drejtpërdrejta janë taksat që vendosen mbi të ardhurat dhe pasurinë.

PO JO

24. Menaxherët në organizatë kryejnë katër funksione bazë. Evidentoni më poshtë katër prej tyre. 4 pikë

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

25. Lidhni me shigjetë dy karakteristikat përkatëse me liderin dhe dy me menaxherin:

4 pikë

<b>Administrator</b>
<b>Novator</b>
<b>Inspiron besim</b>
<b>I bën gjërat si duhen</b>

**Lideri**

**Menaxheri**

26. Një komunikim biznesi është strategjik kur merr parasysh disa elementë kryesorë. Renditni më poshtë 4 prej këtyre elementëve.

4 pikë

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

27. Një proces i mirëfilltë kërkimi kalon në disa faza. Evidentoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

28. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. **4 pikë**

a) Raporti objektiv ose informues ka veçorinë që bazohet vetëm në të dhëna, dëshmi të njerëzve ose detaje të mjediseve, pa marrë parasysh opinionin e shkruarit..

PO      JO

b) Raporti hetimor ose demonstrues karakterizohet nga të qenit objektiv dhe i vërtetë.

PO      JO

c) Raporti interpretues përdoret për të trajtuar çështje të përditshme, të tilla si zakone të reja ose sjellje të grupeve shoqërore.

PO      JO

d) Raporti shoqëror përdoret për të trajtuar çështje të përditshme, të tilla si zakone të reja ose sjellje të grupeve shoqërore.

PO      JO

29. Faktorët thelbësorë për një strategji komunikimi efektiv janë katër. Renditni më poshtë ato: **4 pikë**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

30. Parimet themelore të hartimit të kodit të etikës janë disa. Evidentoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

